



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1450/24 Datë:23.07.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 125-të, mbajtur me datë 03.07.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  1. *Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 45 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, BSc 180 ECTS	Naim Braha Menderes Gashi Ujkan Bajra

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, BSc 180 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Miklos Hoffmann, Mladen Krajacic dhe Ervin Rems, është organizuar më 24.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1), Substancialisht katër (4) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 125-të, mbajtur me datë 03.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër si dhe dispozitave ligjore në fuqi përkatësisht paragrafit 1 të nenit 19 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.